



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë/ Ministarstvo Ekonomije/ Ministry of Economy

Forumi i Solareve të Kosovës 2021

Prishtinë, 27 korrik 2021

Minutat e Takimit dhe Draft Rekomandimet nga pjesëmarrësit

Ministria e Ekonomisë në bashkëpunim me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) si vazhdimësi e takimeve punuese lidhur me tranzicionin e drejtë energjetikë në Kosovë ka organizuar Forumin e Solareve të Kosovës. Në këtë forum kanë marrë pjesë akterët kryesorë të fushës së energjisë së ripërtëritshme në Kosovë (biznese, OJQ, institucione vendore dhe ndërkombëtare) me qëllim të organizimit dhe koordinimit. Ky forum ka pasur për qëllim promovimin e tregut të prosumatorëve dhe të prodhuesve për vetë-konsumim të projekteve të vogla të energjisë solare në Kosovë.

Forumi është ndarë në tri tryeza diskutimi si dhe një panair në të cilin bizneset kanë prezantuar shërbimet dhe produktet e tyre.

Tryeza e parë e diskutimit

Në tryezën e parë të diskutimit është diskutuar informata për gjendjen aktuale si dhe potenciali për solare në Kosovë. Në këtë tryezë pjesëmarrës ishin z. **Miftar Nika** nga ME, z. **Lorik Haxhiu** nga USAID/KESS dhe zj. **Arijeta Pajaziti** nga AWESK. Z. Miftar Nika në emër të ME theksoi rëndësinë e BRE-ve me fokus- Solaret. Z. Nika prezantoi gjendjen aktuale në treg të energjisë, studimet dhe nismat legjislative të ndërmarra në sektor në vitet e fundit si dhe kapacitetet e licencuara nga ZRRE. Për më tepër z. Haxhiu rekomandoi që deri në vitin 2030 të instalohen deri në 250 MW kapacitet totali i prosumers në Kosovë (8000 instalime në sektorin e amvisërisë, 2000 në ndërtesa publike dhe 1000 në biznese). Vlera e analizuar e investimeve është vlerësuar të jetë diku 300 milion euro. Sipas studimit të USAID, Kosova ka kapacitet të përballoj deri 500 MW kapacitet të instaluar nga energjia solare (ankande dhe prosumer) deri në vitin 2030, kjo energji e prodhuar do të kontribuojë 11% të konsumit final të energjisë elektrike. Zj, Pajaziti prezantoi të arriturat e AWESK si dhe kontributin që kanë dhënë në fuqizimin e gruas në sektorin energjetikë.

**ky sesion është moderuar nga zj. Leonita Shabani Mullarama nga ME*

Pyetje/ rekomandime gjatë sesionit të parë nga pjesëmarrësit:

1. Është rekomanduar që strategjia e energjisë të bazohet në dy skenar të rritjes ekonomike: skenari i parë me 4% rritje ekonomike vjetore dhe skenari i dytë me 7-8% rritje ekonomike vjetore.
2. Është rekomanduar që të merren në konsideratë të gjitha metodat e prodhimit të energjisë në kuadër të Strategjisë së re të energjisë.
3. Është rekomanduar të bëhet funksionalizimi i OneStopShop-it në funksion të lehtësimit të procedurave të aplikimit;
4. Sa parashihet të jetë zgjerimi i kapaciteteve gjeneruese për BRE? Cili pritet të jetë caku për vitin 2030?
5. Sa % e caktit do të përfshijë kapacitete për vetë konsum dhe sa për shitje në treg?
6. Sa panele solare do të instalohen në amvisëri?
7. Cila do të jetë skema e re konkurruese/ mbështetëse për zhvillimin e BRE-ve?
8. Cila do të jetë Strategjia për zhvillimin e Resurseve Humane në sektorin e energjisë për lehtësimin e tranzicionit të energjisë?
9. A do të përfshijë strategjia e re politika në funksion të barazisë gjinore në sektorin e energjisë?

Tryeza e dytë e diskutimit

Në tryezën e dytë të diskutimit është diskutuar mbi proceset dhe projektet për Prosumatorët Solarë. Në këtë tryezë pjesëmarrës ishin z. Faruk Serdarevic dhe Anand Subbiah nga USAID/ KESS, zj Besiana Qorraj Berisha nga ME si dhe Gent Hajdari nga USAID/ESA. Z. Serdarevic prezantoi mbi pengesat dhe mundësitë e Prosumatorëve në tregun Kosovar si dhe z. Subbiah prezantoi mbi modelet e financimit të këtyre projekteve. Zj. Berisha prezantoi konceptin dokumentin për BRE si nismë mbi analizimin e opsioneve ligjore që Kosova ka në avancimin e tregut energjetikë. Z. Gent Hajdari prezantoi modelin e zhvilluar nga USAID/ESA mbi krahasimin e projekteve në fushën e BRE-ve dhe benefitet e kalimit nga skema FiT në atë konkurruese.

**ky sesion është moderuar nga zj. Leonita Shabani Mullarama nga ME*

Pyetje/ rekomandime gjatë sesionit të dytë nga pjesëmarrësit:

1. Kur pritet të finalizohet strategjia e energjisë?
2. Kur pritet të fillohet me ligjin për Burime të Ripërtërishme?
3. Dallimi në mes të FiT dhe Premium-it?

Tryeza e tretë e diskutimit

Në tryezën e tretë të diskutimit është diskutuar mbi përvojat dhe mundësitë e zhvillimit të projekteve me kapacitet të vogël të solareve në Kosovë. Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin z. Trim

Tërnavë nga Jaha Solar, Lulzim Sylë nga Elen, Faruk Serdarevic nga USAID/ KESS, Fatos Hasani nga ProCredit Bank dhe Afrim Ajvazi nga ZRRE.

**ky sesion është moderuar nga z. Blin Berdoniqi nga ME*

Pyetje/ rekomandime gjatë sesionit të tretë nga pjesëmarrësit:

1. Të shkurtohen procedurat për marrjen e statusit prosumers në ZRrE , KEDS dhe institucionet tjera të ndërlidhura me procesin;
2. Ndryshimi i statusit nga konsumator në prosumers të mos bëhet me aprovim nga bordi i ZRrE-se por me procedura tjera më të thjeshta.
3. Për licencimin e prosumers kërkohen 18 dokumente prej tyre vetëm 13 janë të nevojshme të tjerat të largohen.
4. Largimi i kufizimit në nivel tensoni 0.4 kV si kriter për prosumers sepse është diskriminues;
5. Largimi i kufizimit të kapacitet instalues prej 100 kW si kriter për prosumers. Është propozuar kapaciteti instalues të lejohet varësisht nga konsumi i aplikuesit (70-80%);
6. Krijimi i një fondi mbështetës për prosumers për mbështetje direkte të kostove investuese në vlerë vjetore prej rreth 5 milion EUR për 5 vite. (kjo do të sillte investim në kapacitete rreth 100-200 MW)
7. U cek se Procredit Bank do të hap ofertën për 3 MW energji nga energjia Solare si vazhdimësi e mbështetjes së projekteve të gjelbërta dhe diversifikimit të portfolios.
8. Janë identifikuar dy barriera kryesore të investitorëve në Kosovë: teknike dhe financiare (sipas përfaqësuesit të Procredit Bank).

Në fund zj. Linda Gjokaj nga KEDS prezantoi platformën informuese për Prosumers si dhe qëllimin e KEDS në akomodimin e këtyre kapaciteteve gjeneruese. Si dhe zj. Arza Krasniqi prezantoi programin e praktikës nga USIAD/ESA në funksion të zhvillimit të kapaciteteve humane në mbështetje të Tranzicionit Energjetik.